



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 263/20
Tarih/Dt. 02.12.2020	



Referenca : 626/20/028/521

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe udhëzuesit të Prokurimit Publik-NDRYSHIM / PLOTESIMIT të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01 neni 4 pika (b) dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 bie këtë :

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik “Visar Kuçi” B.I.; “Nazim Shabanaj” B.I. dhe N.N.SH. “CO- ING” e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 29.11.2020 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-20-6531-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-20-028-5-2-1 me titull “NDËRTIMI I KANALIZIMEVE TË UJRAVE TË ZEZA DHE ATYRE ATMOSFERIKE PËRGJAT RRUGËS KÛLTÛR NË MAMUSHË”.

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Grupi i Operatorëve Ekonomik –“Visar Kuçi” B.I.; “Nazim Shabanaj” B.I. dhe N.N.SH. “CO- ING” nga Suhareka më datën 29.11.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues, ku me këtë njoftim është përcaktuar përfituesi i tenderit me titull: “NDËRTIMI I KANALIZIMEVE TË UJRAVE TË ZEZA DHE ATYRE ATMOSFERIKE PËRGJAT RRUGËS KÛLTÛR NË MAMUSHË”.

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1, të rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave dhe kemi konstatuar se të gjitha pretendimet e parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik –“Visar Kuçi” B.I.; “Nazim Shabanaj” B.I. dhe N.N.SH. “CO- ING”, janë të pa bazuara për arsyet e cekura më poshtë.

Grupi i O.E në pretendimin e parë, ka cekur se kinse në kemi bërë shkelje të dispozitave të LPP konkretisht të nenit 6 e që ka të bëjë me ekonomicitetin dhe efikasitetin e fondeve publike. Në si AK i kemi respektuar dispozitat e këtij neni si dhe dispozitat e nenit 59 në të cilin është paraparë që vetëm tenderët të cilët i plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktues konsiderohen të përgjegjshëm. Në RROUP në nenin 41 paragrafi 41.3 janë paraparë parimet e vlerësimit ndër të cilat është paraparë që tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara. Në dosjen e tenderit nenin 5.2 si dhe në njoftimin për kontratë në nenin II.3 është përcaktuar afati për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës i cili është paraparë që të jetë 30 ditë. Në dosjen e tenderit nenin 5.2 është paraparë që:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë planin dinamik për ekzekutim të kontratës sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

- Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 (Tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes së urdhërblerjës nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.)

Pra kërkesa e lartcekur ka qenë shumë e qartë. Pretendimi se nuk janë kërkesat e njëjta në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë është i pa bazuar. Sistemi elektronik i prokurimit, nuk lejon shpjegime në piken ku është paraparë afati i realizimit apo vlefshmërisë të kontratës, andaj kërkesa është parashtruar me numër si në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe është paraqitur në dosje të tenderit sikur e kemi cekur më lartë. Andaj për shkak të mos dorëzimit të planit dinamik, tenderi juaj është cilësuar si tender i pa përgjegjshëm, ndërsa në bazë të legjislacionit të prokurimit, vetëm tenderët e përgjegjshëm të cilët i plotësojnë të gjitha kërkesat e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues mund të shpërblehen me

kontratë. Andaj pretendimi se janë shkelur dispozitat e këtij neni është i pa bazë pasi që edhe pse O.E. ankues ka ofruar çmimin më të ulët, nuk ka ofruar tender të përgjegjshëm.

Në pretendimin e dytë O.E ka cekur se kemi bërë shkelje të dispozitave të LPP konkretisht të nenit 7 në të cilin është paraparë Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, me pretendimin se nuk është zbatuar neni 72 për të kërkuar sqarim në lidhje me planin dinamik. Por neni 72 në paragrafin 3 shprehimisht ka paraparë që: Citat “Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”. Plani dinamik nuk është një dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar andaj ne nuk kemi kërkuar sqarim në lidhje me këtë pikë. Ndërsa nga O.E. tjetër kemi kërkuar sqarim në lidhje me certifikatën e TVSH-s të cilën vetëm njëri nga anëtarët e grupit nuk e ka dorëzuar me rastin e dorëzimit të tenderit. Dihet botërisht se certifikata e TVSh-s e ka datën e fiksuar, është dokument që mund të verifikohet në mënyrë objektive sepse lëshohet nga ATK, e cila është organ shtetëror. Pra sipas sqarimit më lartë, konsiderojmë që edhe ky pretendim nuk është i bazuar pasi që ne kemi trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të gjithë O.E. pjesëmarrës.

Sa i përket pretendimit të tretë të O.E-s se AK ka bërë shkelje të RRUOPP-s konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit, konsiderojmë që është i pabazuar pasi që ne kemi aplikuar me përpikëri këtë nenin 59 të LPP-s gjatë vlerësimit si dhe kemi aplikuar me përpikëri edhe dispozitat e nenit 41 paragrafi 41.1, 41.2 dhe 41.12 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, duke ju përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Të nderuar ne si autoritet kontraktues jemi të thirrur dhe kemi kompetenca që ne rast të shpalljes, hapjes, vendimit për tender dhe gjatë gjithë procedurës tjetër, të veprojmë sipas legjislacionit në fuqi e cila rregullon fushën e Prokurimit, andaj edhe në këtë rast kemi ndjekur të gjitha hapat e kërkuara nga LPP-ja për procedurën në fjalë.

Ndërkaq sa i përket pretendimeve të parashtruara nga O.E ankues, konsiderojmë që nuk janë të bazuara, sepse sa i përket pretendimeve që kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar ne përpikëri të gjithë procedurën. Në analizimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të çështjeve të cilat O.E. ankues i ka theksuar në kërkesën për

rishqyrtim, aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP-s.

Andaj

Me qenë se Operatori Ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë duke mos pasur kurrfarë baze juridike në parashtrimin e kërkesës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, 02.12.2020

Gazmend Gashi

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna Mamushë



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.